



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

KONTRATË

Nr. 5255 datë 30.10.2015

2

**OBJEKTI: “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni për DAP-in ” Loti III
“Blerje printer, fotokopje, skaner “**

Sot më datë 30.10.2015, është lidhur kjo kontratë, midis palëve të mëposhtme (këtu e në vijim referuar si “Kontrata”):

1. **Departamenti i Administratës Publike**, më poshtë cituar si Autoriteti Kontraktor, person juridik publik, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 1, Këshilli i Ministrave, Tiranë, me numër **Nipt** K91411451R, përfaqësuar nga Drejtori i Departamentit Znj. Albana Koçiu.

dhe

2. **Operatorit Ekonomik “BNT Elektronik’s” shpk** më poshtë cituar si Kontraktuesi me numër **Nipt** J61817047D, me adresë Bulevardi Zhan Dark, nd.32, hyrja 16, kati 2, apt.1, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Jovan Bojdani.

Baza Ligjore:

Kontrata hartohet në bazë të autorizimit për lidhje kontrate me Nr. 44/9 Datë 30/09/2015 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ligji nr 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar), VKM nr 914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimeve Publike, ligjit Nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Palët nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të cilësuar me lart në këtë kontratë, deklarojnë me vullnetin e tyre të lirë e të plotë se lidhin kontratën në kushtet që vijojnë:

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
MALLRAT TENDER I HAPUR**



Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë ri shprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë ri shprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Entit prokurues dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentet e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkëngjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot, dhe rrisqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktor.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.



- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gazshme.
- 2.9 “Shërbimet në Lidhje me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet në Lidhje me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentet e Tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Objekti i Kontratës

- 4.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate, Kontraktori merr përsipër “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni për DAP-in dhe AZRT-në”, Loti III “Blerje printer, fotokopje, skaner” sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.rendor	Departamenti I Administrates Publike	Njesia	cmimi pa TVSH/pe r njesi	sasia	vlera totale pa tvsh
1	FOTOKOPJE Multifunction High Volume Copy Machine Toshiba e-Studio 557	Cope	448.500	2	897.000
Totali pa TVSH					897.000
TVSH					179.400
Totali me TVSH					1.076.400

Neni 5 Vlera e Kontratës

- 5.1 Vlera totale e kontratës është:
- 897,000 (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa tvsh.
 - 1,076,400 (një milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë me tvsh.

Neni 6



Kohëzgjatja e Kontratës

Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të ketë efekte deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve kontraktuale.

Neni 7

Praktikat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 7.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 7.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumenteve të Tenderit për këtë prokurim.
- 7.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 8

Informacioni Konfidencial

- 8.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 8.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumente të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 8.1 më sipër.

Neni 9

Prona Intelektuale

- 9.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specififikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumenteve dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake më shkrim nga Autoriteti Kontraktor.



- 9.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor nga mos përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 9.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 10 **Origjina e Mallrave**

- 10.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 10.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 10.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 10.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nën kontraktuesit që siguron materialet.

Neni 11 **Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, në se ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në pajtim me kontratën në se ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 11.3 Në se shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 12 **Përshtatshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 12.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.



- 12.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër të kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare të tanishme. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 12.3 Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktues me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 12.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të pronës (Mallrave) për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitësit (Kontraktuesit).

Neni 13 **Pjesët e Këmbimit**

- 13.1 Në se kontrata parashikon, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e dhëna një sasi pjesësh këmbimi, në akordim me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 13.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 13.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 13.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor në kohë të mjaftueshme për të lejuar Autoritetin Kontraktor të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 13.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japi gratis Autoriteti Kontraktor në se ai kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 14 **Ambalazhimi**

- 14.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 14.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në pajtim me kontratën në se ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, në se mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.



Neni 15

Testimet dhe Inspektimet

- 15.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës.
- 15.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 15.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të bie dakord të ndryshojë grafikun e lëvrimin.
- 15.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 15.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Mallrave nuk do ta çlirojë Kontraktuesin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 16

Kushtet e Dorëzimit

- 16.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit me përjashtim kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një "Incoterm" përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.
- 16.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.
- 16.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve në Lidhje me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.
- 16.4 Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.
- 16.5 Kontraktuesi është i detyruar t'i japi Autoriteti Kontraktor njoftim të arsyeshëm për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.

Neni 17

Transportimi i Mallrave

- 17.1 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin e Mallrave siç kërkohet me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuar në kontratë.
- 17.2 Nëse Enti prokurues është i detyruar të marrë Mallrat nga ndonjë mjet transporti apo agjenci transporti, Kontraktuesi duhet të japë lajmërim paraprak të arsyeshëm për



transportin dhe t'i japi Entit prokurues të gjitha dokumentet e nevojshme për marrjen e Mallrave.

- 17.3 Në se shitësi, [Kontraktuesi] është i detyruar t'i dorëzojë mallrat në mjetin e transportit në një vend të specifikuar në kontratë, risku i humbjes kalon tek Autoriteti Kontraktor vetëm kur mallrat i dorëzohen mjetit të transportit në vendin e specifikuar. Fakti se shitësi [Kontraktuesi] është i autorizuar të mbajë dokumentet përfaqësuese të mallrave nuk influencon në kalimin e rrishtit.

Neni 18

Siguracioni

- 18.1 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, Kontraktuesi duhet të sigurojë se Mallrat që do dorëzohen sipas kontratës janë plotësisht të siguruara ndaj humbjes ose dëmtimit gjatë transportit, magazinimit ose dorëzimit të tyre.

Neni 19

Ekzaminimi dhe Pranimi i Mallrave

- 19.1 Përpara pranimit, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ekzaminojë, inspektojë dhe testojë Mallrat. Ky aktivitet duhet të bëhet menjëherë pas dorëzimit të Mallrave. Kontraktuesi ka të drejtë të marrë pjesë në këtë aktivitet dhe të shqyrtojë raportet e aktivitetit të përgatitura nga Autoriteti Kontraktor ose agjentët e tij.
- 19.2 Autoriteti Kontraktor duhet të pranojë ose refuzojë Mallrat menjëherë pas dorëzimit dhe duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për veprimin e tij për të pranuar ose refuzuar Mallrat.

Neni 20

Garancitë

- 20.1 Kontraktuesi garanton se Mallrat janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se ato trupëzojnë përmirësimet e fundit në skicim dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.
- 20.2 Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për çdo defekt ose mospërputhje që ekziston në momentin kur rrishtu kaloi tek Autoriteti Kontraktor, edhe kur defekti shfaqet pas këtij momenti.
- 20.3 Shitësi (Kontraktuesi) mban përgjegjësi për mospërputhjen që verifikohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm dhe që vjen nga mos përmbushja e ndonjë detyrimi, duke përfshirë garancinë që Mallrat duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e tyre të zakonshëm dhe specifik për një periudhë të caktuar kohe, ose se ato do të ruajnë cilësitë dhe karakteristikat e caktuara.
- 20.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë ose nga ligji, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën e tij për të kundërshtuar për të metat e sendit në se ai nuk i



- denoncon ato te shitësi (Kontraktuesi), duke specifikuar natyrën e tyre, brenda dhjetë ditësh nga zbulimi i tyre.
- 20.5 Autoriteti Kontraktor duhet t'i sigurojë Kontraktuesit të gjitha mundësitë e arsyeshme për Kontraktuesin për të inspektuar këto defekte.
- 20.6 Pas marrjes së këtij njoftimi, Kontraktuesi duhet të riparojë menjëherë ose të zëvendësojë Mallrat defektive ose pjesët e tyre gratis për Autoritetin Kontraktor.
- 20.7 Në se pas marrjes së njoftimit, Kontraktuesi dështon në rregullimin e defektit brenda një periudhe të arsyeshme, Autoriteti Kontraktor mund të procedojë, me shpenzimet e Kontraktuesit, të ndërmarrë veprime për rregullimin e nevojshëm.
- 20.8 Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit në se ai nuk e ushtron të drejtën e tij brenda dy vjetësh nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po qe se ky afat nuk bie në kundërshtim me kohëzgjatjen e garancisë kontraktore.
- 20.9 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mund të shfrytëzojë rregullat e parashikuara këtu në se defektet kanë të bëjnë me fakte të njohura prej tij ose që nuk mund të ishin të panjohura për të dhe që nuk i janë vënë në dukje Autoritetit Kontraktor.

Neni 21 Çmimi i Kontratës

- 21.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 21.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, çmimi i kontratës përfshin kostot dhe tarifat, duke përfshirë taksat dhe tarifat doganore të lidhura me dorëzimin e Mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, instalimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualet dhe dokumentet në gjuhën e specifikuar dhe të nevojshme për përdorim të rregullt, mirëmbajtje dhe riparime të Mallrave. Çmimi i taksave dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas ligjeve në fuqi 28 ditë para hapjes së ofertave.

Neni 22 Afatet e Pagesës

- 22.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 22.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për botimin të njoftimit të kontratës.
- 22.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit Kontraktor me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan Mallrat e dorëzuara dhe shërbimet e kryera.



- 22.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për Mallrat do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë pranuar Mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më vonë.
- 22.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 23

Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 23.1 Shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamatën e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamatës parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.
- 23.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dëm. Nëse kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.
- 23.3 Nëse kontrata parashikon transportim periodik ose në grup të Mallrave dhe pala kontraktuese nuk ka paguar për transporte të mëparshme, Kontraktuesi ka të drejtë të ndalojë transportin e grupeve të tjera deri sa të paguhet duke përfshirë edhe interesin e fituar.

Neni 24

Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 24.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 25

Forca Madhore

- 25.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 25.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 25.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme,



Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 26

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 26.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 26.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së zbatimit të specifikuar në kontratë.
- 26.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 26.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakord për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 26.5 Autoriteti Kontraktor mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë me përpikmëri Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakord me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 27

Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

- 27.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 28

Negociatat dhe Amendamentet

- 28.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.



- 28.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoriteti Kontraktor.
- 28.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 29 **Ndryshimi i Porosisë**

- 29.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Mallra ose Shërbime shtesë deri në një madhësi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Neni 30 **Ndërprerja për Mosplotësim**


- 30.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- a) Kontraktuesi dështon në dorëzimin e Mallrave brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 30.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 31 **Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

- 31.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.
- 31.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 32 **Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

- 32.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 32.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.



- 32.3 Autoriteti kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Mallrat e pranuar dhe Shërbimet në Lidhje me to të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Shërbimeve në Lidhje me to. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 33

Nën kontraktimi

- 33.1 Një nën kontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.
- 33.2 Kontraktori nuk duhet të nën kontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nën kontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nën kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 33.3 Çdo nën kontraktor duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nën kontraktori për mallrat që do të furnizojë.
- 33.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nën kontraktorit.

Neni 34

Transferimi i të Drejtave

- 34.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 35


Sigurimi i Kontratës

- 35.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.
- 35.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesi në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 35.3 Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së pranimin të Mallrave. Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontratës.

Neni 36

Baza Ligjore

- 36.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.



Neni 37
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 37.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 37.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 38
Përfaqësimi i Palëve

- 38.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.
- 38.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 38.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta, rast në të cilin njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 39
Lajmërimet

- 39.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 39.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 40
Llogaritja e Afateve

- 40.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.



**KUSHTET E VEÇANTA
MALLRAT – PROCEDURË E HAPUR**

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës dhe do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast konflikti, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë mbi ato të Kushteve të Përgjithshme.

**Neni 1
Përkufizime**

Autoriteti Kontraktor është **“Departamenti i Administratës Publike”**.

Kontraktuesi është **“BNT Elektronik’s” shpk.**

**Neni 2
Sigurimi i Kontratës ()**

Sigurimi i Kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* 107.640 (një qind e shtatë mijë e gjashtë qind e dyzet) lekë, duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.


Sigurimi i Kontratës do t’i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së realizimit të kontratës.

**Neni 3
Objekti i Kontratës**

Nëpërmjet kësaj Kontrate, Kontraktori merr përsipër “Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni për DAP-in dhe AZRT-në”, Loti III “Blerje printer, fotokopje, skaner“ sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.rendor	Departamenti I Administrates Publike	Njesia	cmimi pa TVSH/pe r njesi	sasia	vlera totale pa tvsh
1	FOTOKOPJE Multifunction High Volume Copy Machine Toshiba e-Studio 557	Cope	448.500	2	897.000
Totali pa TVSH					897.000
TVSH					179.400
Totali me TVSH					1.076.400

**Neni 4
Vlera e Kontratës**



Vlera totale e kontratës është:

- 897,000 (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa tvsh.
- 1,076,400 (një milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë me tvsh.

Neni 5 Kohëzgjatja e Kontratës

Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të ketë efekte deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve kontraktuale.

Neni 6 Fillimi i Zbatimit

Zbatimi i kontratës do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan Kontratën.

Neni 7 Inspektimet dhe Testimet

Inspektimet dhe testimet para pranimit të Mallrave do të bëhen në: **ambientet e Departamentit të Administratës Publike** me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 1, Këshilli i Ministrave, Tiranë.

Neni 8 Kushtet e Dorëzimit

Data (t) dhe vendi (et) i dorëzimit të Mallrave do të bëhet sipas Grafikut të Lëvrimit të parashikuar në këtë kontratë.

Mallrat objekt i kesaj kontrate, do te furnizohen ne magazinën e Autoritetit Kontraktor te çliruar nga te gjitha detyrimet (vlefte malli, dogana, shpenzime transporti, Tvsh, si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale dhe ligjore), në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit si dhe ofertën e Kontraktuesit të paraqitur në tender.

Mallrat, objekt i kësaj kontrate, do të lëvrohen nga Kontraktuesi me mjetet e tij, në magazinën e Autoritetit Kontraktor, brenda afatit kohor **30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës** të shoqëruara me Faturë tatimore shitjeje.

Mallrat do te jenë të ambalazuara në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre. Mallrat do të shoqërohen me dokumentet e mëposhtme:



- **Certifikate e Cilësisë (CE).**
- **Certifikate e Origjinës së mallit.**
- **Garancinë që shoqëron mallin.**

Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor 5 (pesë) ditë para çdo dorëzimi të Mallrave.

Lajmërimi i dorëzimit duhet të bëhet me shkrim, faks, postë, e-mail etj, tek Departamenti i Administratës Publike, tel: 04 2235 937.

Nëse Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga një palë e tretë, lajmërimi i dorëzimit duhet të përfshijë listën e dokumenteve të nevojshme për marrjen e Mallrave dhe të tregojë se ku dhe kur do t'i jepen dokumentet Autoriteti Kontraktor.

Nëse Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga një palë e tretë, Kontraktuesi duhet të dorëzojë të gjitha dokumentet e nevojshme për marrjen e Mallrave tek: **ambientet e Departamentit të Administratës Publike** me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 1, Këshilli i Ministrave, Tiranë, tel: 04 2235 937.

Neni 9 Kushtet e Pagesës

Pagesa e Mallrave duhet bërë brenda 30 ditëve nga data e pranimit të Mallrave.

Të dhënat e llogarisë së Kontraktorit

Nr. i llogarisë: Iban: AL 892 1311 044 000 000 000 0120

Banka: Banka Popullore Dega Tirane

Monedha e pagesës do të jetë Lek. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 10 Pagesa Paraprake

Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

Neni 11 Shërbimet në Lidhje me to

Kushtet e veçanta të mëposhtme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura:

Neni 12 Zbritja e garancisë së kontratës



Garancia e kontratës do të jetë 5 % e vlerës të sigurimit të kontratës. Garancia e kontratës do ti jepet Kontraktorit deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë për të gjitha pajisjet.

Neni 13

Garancia, kushtet dhe mirembajtja

- Kontraktuesi garanton se pajisjet objekt kontrate janë të reja, të përdorura dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.
- Pajisjet e objekt i kesaj kontrate kane garanci sipas ofertes teknike bashkengjitur por ne garanci nuk perfshihen pjeset e konsumit si drum-i dhe tonerat.
- Garancia fillon qe ne momentin e dorezimit te mallit tek bleresi.
- Garancia nuk perfshin:
 - a) defektet e shkaktuara nga keqperdorimi i pajisjeve ose i programeve te saj;
 - b) defektet e shkaktuara nga termetet, demtimet e shkaktuara nga levizjet dhe goditjet e tensioneve te shkaktuara nga rrjeti elektrik;
 - c) pajisjet nuk mbulohen nga garancia edhe nese nuk eshte plotesuar ky afat nese konstatohen nderhyrje nga persona te pa autorizuar nga BNT Electronics si dhe ne rastet kur kontraktuesi perdore tonera ose pjese jo orijinale.

Neni 14

Të Drejtat dhe Detyrimet e Kontraktuesit

Kontraktuesi merr persiper :

- Te furnizojë Autoritetin Kontraktor nga ana sasiore dhe cilesore me te gjithe mallin konform specifikimeve teknike, afatit dhe kushteve te levrimit, te pranuar dhe te marre persiper ne oferten e tij.
- Transportin dhe sigurimin (all risk) te mallrave objekt i kesaj kontrate, deri ne dorezimin e tyre ne magazinën e Autoritetit Kontraktor.
- Nese eshte e nevojshme, te marre pjese se bashku me specialistet e caktuar nga AK, ne procedurat e verifikimit fizik të sasisë, cilësisë, çmimit dhe marrjes në dorëzim të aktiveve te furnizuara dhe perpilimin e dokumentacionit perkates, brenda 5 (perse) diteve nga data e dorezimit te tyre prane autoritetit kontraktor.
- Pergjegjesine per cdo mangesi ose mosperputhje qe ekziston ne momentin e kalimit te riskut te bleresi, edhe kur te metat shfaqen pas ketij momenti, brenda 5 (pese) diteve nga data e zbulimit te tyre.
- Pergjegjesine per mosperputhjen qe vertetohet brenda 10 (dhjete) diteve nga data e zbulimit te tyre dhe qe vjen nga mospermbushja e ndonje detyrimi, duke perfshire garancine qe mallrat duhet te jene te pershtatshme per perdorimin e tyre te zakonshem dhe specifik per nje periudhe kohe, ose se ato do te ruajne cilesite dhe karakteristikat dhe te mos kene difekte te fshehta.
- Te pranoje apo te refuzojë reklamimin(et) e bleresit per mallrat qe rezultojne difektoze pas dorezimit te mallrave objekt i kesaj kontrate. AK njofton me shkrim reklamimet brenda 10 diteve nga data e konstatimit te tyre. Nese shitesi brenda 10 diteve nga data e marrjes se njoftimit me shkrim nuk kthen pergjigje, reklamimi do te konsiderohet i pranuar. Kontraktuesi duhet te paraqitet ne zyrtar e AK per te saktësuar dhe zgjidhur objektin e reklamimit, brenda 5 diteve nga



marrja e njoftimit me shkrim te reklamimit. Nese malli i sjelle eshte jashte parametrave te parashikuara ne kontrate, kontraktuesi eshte i detyruar te beje zevendesimin e mallrave te cilat jane jashte parametrave te percaktuara ne kontrate.

- Të kryejë mirëmbajtje parandaluese cdo 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës, dhe kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.
- Për cdo problem që raportohet nga Autoriteti Kontraktor duhet të përgjigjet brenda 2(dy) orëve nga marrja e njoftimit.
- Për cdo difekt te konstatuar të rëndë duhet të masa për zëvendësimin e pjesëve brenda 2 dite kalendarike nga marrja e njoftimit. Të gjitha lëvizjet dhe zhvendosjet e pajisjeve do të jenë pa pagesë. Kjo përfshin heqjen, ri-instalimin dhe testimin e pajisjeve.
- Për cdo kontroll të kryer të mbajë dokumentacion përkatës dhe një kopje ta dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor
- Të vendosi numër kontakti dhe adresë emaili për komunikimin me Autoritetin Kontraktor.

Neni 15

Të Drejtat dhe Detyrimet e Autoritetit Kontraktor

Autoriteti kontraktor merr përsipër:

- Të kryejë pagesat për mallrat e furnizuar Kontraktuesit, brenda 30 ditëve nga dita e verifikimit fizik të sasisë, cilësisë, çmimit dhe marrjes në dorëzim të aktiveve te furnizuara.
- Të refuzojë mallrat e furnizuar nga Kontraktuesi në rast se ato nuk përmbushin karakteristikat sasiore e cilesore të pranuar ne ofertën e dorëzuar prej tij, sipas afateve të percaktuara në këtë kontratë.
- Verifikimet e pajisjeve përsa i përket cilësisë, çmimit dhe marrjes në dorëzim brenda 5 (pesë) ditëve nga data e dorëzimit të tyre pranë AK. Në mungesë të reklamimit me shkrim brenda këtij afati, pajisjet konsiderohen të pranuar.

Neni 16

Rastet e zgjidhjes së kontratës

AK mund të ndërpresë kontratën, nëse:

- Kontraktuesi dështon në lëvrimin e mallrave brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë.
- Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- AK do t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë kohë të ndreqë mosplotësimin, me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.
- AK mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë, dhe anasjelltas. Kontraktuesi duhet t'i japi AK njoftim me shkrim për ndërprerjen.
- AK duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha mallrat e pranuar dhe shërbimet në lidhje me to, të kryera përpara ndërprerjes. Zgjidhja e kontrates ne menyre të njëanshme nuk përjashton detyrimin e AK për të kryer pagesat për mallrat e lëvruara.



Neni 17
Të Ndryshme

- Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe mund të ndryshohet vetëm me miratimin me shkrim nga të dy Palët.
- Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- Në rast të pamundësisë së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me mirëkuptim të dyanshëm, secila palë ka të drejtë ti drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që ushtron kompetencë për mosmarrëveshje konkrete.
- Kjo Kontratë hartohet në 4 (katër) kopje, ku 3 (tre) kopje janë për Autoritetin Kontraktor dhe 1 (një) kopje për Kontraktorin. Çdo kopje ka të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtën vlerë ligjore.

Kësaj Kontrate i bashkëngjitet:

- *Autorizimi për lidhje kontrate Nr. 44/9 Prot datë 30.09.2015*
- *Urdhër Prokurimi Nr. 44/1 datë 28.07.2015*
- *Formulari i Njoftimit të Fituesit Nr. 44/6 Prot datë 23.09.2015*
- *Njoftimi i fituesit publikuar në buletin e APP – së nr. 38 datë 28.09.2015*
- *Formulari i Ofertës*
- *Specifikimet teknike*
- *Sasia dhe grafikun e lëvrimit*
- *Deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike*
- *Deklarata mbi certifikatat e cilesise dhe origjines se mallit*
- *Deklarata mbi furnizimin e mallit*
- *Deklarata që pajisjet nuk janë assembluar në Shqipëri*
- *Formulari i Sigurimit të Kontratës Nr. Serie 0001667 datë 23/10/2015 nga Shoqëria e Sigurimeve “Sigma Interalbanian vienna Insurance Group”.*

Autoriteti Kontraktor

Kontraktuesi

Departamenti i Administratës Publike

BNT Elektronik's shpk

ALBANA KOÇIU

JOVAN BOJDANI

